



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

---

**Njoftim për mediat**

**Për seancën konsultative me Entin Rregullator të Energjisë në lidhje me raportin  
“Mbi monitorimin e tregut të energjisë elektrike”**

**Tiranë 21.06.2010** – Në kuadër të monitorimit të tregut të energjisë elektrike, Autoriteti i Konkurrencës organizoi sot një seancë konsultative me përfaqësues të Entit Rregullator të Energjisë (ERE). Në këtë takim u diskutua mbi raportin e Autoritetit të Konkurrencës për tregun e energjisë elektrike dhe rekomandimet përkatëse për liberalizimin e mëtejshëm të këtij tregu.

Përfaqësuesit e ERE ishin përgjithësisht dakord me konkluzionet e grupit të punës dhe ishin të hapur për bashkëpunim të mëtejshëm të të dy institucioneve për të rritur konkurrencën në këtë treg. Ata njoftuan Autoritetin e Konkurrencës se një pjesë e shqetësimeve të paraqitura janë në rrugën e zgjidhjes si dhe treguan hapat konkret që po ndërmerren në këtë drejtim.